



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

**K.P.P.415/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të KVO-së në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Gjeokonsult&Co”, në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me nr. REF-42173-01-25-2018, me objekt “*Studim Projektim Rehabilitim i lagjeve nr.4,5,6 Bashkia Kukës*”, me fond limit 2,530,000 lekë (pa TVSH), publikuar në datën 26.01.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

**Ankimues:**

BOE “Invictus” & “C.E.C Group” shpk  
Njësia Nr.9, Rruga “Don Bosko”, Pall. Aurora Konstruksion, Sek.4,  
Kati.3, Ap.1, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Kukës  
Sheshi “Skenderbej“, lagjia Nr.5, Kukës

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.01.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Shërbim Konsulence”, me nr. REF-42173-01-25-2018, me objekt “Studim Projektim Rehabilitim i lagjeve nr.4,5,6 Bashkia Kukës”, me fond limit 2,530,000 lekë (pa TVSH).

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më datë 07.05.2018 me shkresën nr.2104/1 datë 04.05.2018, rezulton se në datën 21.02.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit), ku rezulton se kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë:

- G&K
- ASH Enginerring
- Land&Co
- B-Vaal Engineering
- Invictus&C.E.C Group
- Viante Konstruksion
- Dea Studio
- A&I Design
- Derbi-E

- Gjeokonsult&Co

II.3. Në datën 27.02.2018 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, nga ku rezulton se në këtë fazë janë kualifikuar dhe skualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:

- |                        |                |
|------------------------|----------------|
| - G&K                  | I skualifikuar |
| - ASH Enginerring      | I skualifikuar |
| - Land&Co              | I skualifikuar |
| - B-Vaal Engineering   | I skualifikuar |
| - Viante Konstruksion  | I skualifikuar |
| - Dea Studio           | I skualifikuar |
| - A&I Design           | I skualifikuar |
| - Derbi-E              | I skualifikuar |
| - Gjeokonsult&Co       | I kualifikuar  |
| - Invictus&C.E.C Group | I kualifikuar  |

II.4. Në datën 23.03.2018 është zhvilluar faza e dytë e procedurës në të cilën operatorët ekonomikë të kualifikuar paraqitën propozimet e tyre teknike dhe ekonomike.

II.5. Në datën 28.03.2018 KVO-ja përfundoi vlerësimin të ofertave teknike të ofertuesve të kualifikuar si më poshtë:

- |                        |         |
|------------------------|---------|
| - Gjeokonsult&Co       | 84 pikë |
| - Invictus&C.E.C Group | 83 pikë |

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se po në datën 28.03.2018, KVO pas vlerësimit të propozimeve teknike, vijoi më tej me procesin e hapjes së zarfave, që përmbanin propozimin ekonomik si më poshtë:

Gjeokonsult&Co	2,200,000 lekë pa tvsh	87.2 pikë
BOE Invictus& C.E.C Group	2,500,000 lekë pa tvsh	84 pikë

II.7. Në datën 30.03.2018 me shkresën nr.1606 prot autoriteti kontraktor i ka dërguar BOE Invictus& C.E.C Group “njoftimin për klasifikimin e ofertave” të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datën 10.04.2018, operatori ekonomik BOE “Invictus” & C.E.C Group” ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si më poshtë:

- Në përgjigje të shkresës zyrtare nr.1606 prot datë 30.03.2018 për klasifikimin e ofertave ju bëjmë me dije se: nuk jemi dakord me vendimin e autoritetit kontraktor për kualifikimin e operatorit Gjeokonsult &Co për katër arsye kryesore.
  1. AK dhe OE nuk kanë respektuar udhëzimin e APP me Nr.5585 prot datë 25.07.2017 dhe Nr.13565 prot datë 06.11.2017 me lëndë “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM Nr.354 datë 11.05.2016

2. OE në propozimin teknik nuk ka dorëzuar formularin e dorëzimit të propozimit sipas DST që garanton AK për kryerjen me sukses të shërbimit sipas Detyrës së Projektimit, Termave të Referencës dhe Ftesës për Ofertë. Ky dokument nuk është pasqyruar në procesverbalin e hapjes së propozimit teknik të mbajtur në datën 23.03.2018.
3. OE në propozimin ekonomik ka ofertuar vlerë e cila është poshtë kufirit minimal të përcaktuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 e për rrjedhojë oferta është e papërgjegjshme po ti referohemi vendimit KPP nr.131/2018. Nga llogaritjet matematikore të fondit limit 2,530,000 lekë pa tvsh vlera minimale e lejuar është 2,270,522 lekë pa tvsh. Vlera 2,200,000 lekë pa tvsh e ofertuar nga Gjeokonsult&Co është poshtë kufirit të lejuar.
4. AK nuk respekton kërkesat e ftesës për propozim konkretisht të dhënave teknike si llogaritja e kostove dhe grupet tarifore.
5. Kërkojmë që grupi i hartimit të fondit limit të kësaj procedure të deklarojë sa është fondi minimal i lejuar nga VKM nr.354 datë 11.05.2016. Sipas shkresës së APP vlera maksimale e llogaritur e fondit limit referuar shkresave të APP është 2,530,000 lekë pa tvsh.

II.9. Në datën 16.04.2018, nëpërmjet shkresës me nr.15 prot datë 13.04.2018, operatori ekonomik ankimes është vënë në dijeni nga autoriteti kontraktor lidhur me mospranimin e ankesës.

II.10. Në datën 25.04.2018 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr. 2104/1 prot., datë 04.05.2018, protokolluar me tonën me shkresën nr.809/2 datë 07.05.2018, dhe shkresën nr.2644/1 prot datë 14.06.2018 protokolluar me tonën me nr.809/4 datë 18.06.2018 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “Invictus” & “C.E.C Group” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Gjeokonsult&Co me arsyetimin se “OE në propozimin ekonomik ka ofertuar vlerë e cila është poshtë kufirit minimal të përcaktuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 e për rrjedhojë oferta është e papërgjegjshme po ti referohemi vendimit KPP nr.131/2018. Nga llogaritjet matematikore të fondit limit 2,530,000 lekë pa tvsh vlera minimale e lejuar është 2,270,522 lekë pa tvsh. Vlera 2,200,000 lekë pa tvsh e ofertuar nga Gjeokonsult&Co është poshtë kufirit të lejuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr.2644/1 prot datë 14.06.2018 protokolluar me tonën me nr.809/4 datë 18.06.2018, KPP konstaton se përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga ky i fundit është bërë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

III.1.3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” sipërcituar në nenin 1 të tij “Fusha e Veprimit” parashikon shprehimisht se: *Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e palnifikimit, projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës) të financuara me fonde publike, të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.*

Ndërsa në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se: *Tarifat për shërbimet duhet të jenë në një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale të përcaktuara në këtë manual në përputhje me LPP. Pika 3 e nenit 7 parashikon se: Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa taifa minimale të specifikuara nga ky manual.*

III.1.4. Në Rekomandimin Nr. 5585 Prot datë 25.07.2017 të APP-së; “Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyerje dhe kolaudim”, parashikohet si më poshtë:

- *Per sherbimet e parashikuara ne vendimin e sipercituar (Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016), APP rekomandon qe, krahas perlllogaritjes se fondit limit (i cili perlllogaritet nisur nga perqindja maksimale e lejuar), behet perlllogaritja e vleres minimale te lejuar (e cila perlllogaritet nisur nga p erqindja minimale e lejuar), ne varesi te kategorise dhe grupit tarifor , ku ben pjese objekti i prokurimit*
- *Ne nenin 7, pika 3, te vendimit te sipercituar, parashikohet se: "Ne rrethana te jashtezakonshme dhe nese dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund te jene me te uleta sesa normat minimale, te specifikuara nga ky manual".*
- *Ne kete kontekst rekomandojme qe, ne rastet kur nuk dokumentohet rrethana e jashtezakonshme, autoritetet kontraktore gjate vleresimit te ofertave, duhet t'i referohen vleres minimale te perlllogaritur per secilin rast, ne haze te parashikimeve ne VKM Nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim".*
- *Ne paraqitjen e ofertave ne kete lloj procedure prokurimi, operatoret ekonomike duhet te mbajne ne konsiderate edhe vlerat minimale te perlllogaritura nga autoritetet kontraktore ne zbatim te VKM Nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim".*

III.1.5. Qëllimi i VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” është që të mbrojë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale



që do të bëhen, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm.

Kjo VKM e posaçme ka për qëllim të zgjidhë situatën e vështirë të krijuar në afrimin dhe përzgjedhjen e personave fizikë, apo juridikë të interesuar, të kontraktohen për shërbimet e kërkuara, pasi shpesh ka rezultuar edhe me uljen e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Efekti i zbatimit të kësaj VKM është rritja e cilësisë së produktit të marrë në fushën e studimit, projektimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, nëpërmjet afrimit të profesionistëve të dalluar, duke përafruar nivelin e pagave që ato t'i përgjigjen realitetit të tregut të sotëm.

Gjithashtu, referuar edhe frymës së legjislacionit të posaçëm në fuqi, në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektuale që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim, sepse vetëm nëse do të mbeteshim tek argumentimi i analizës së kostos nëse ajo do të rezultonte anomalisht e ulët, atëherë kjo analizë do të ishte shumë subjektive, aq më tepër kur autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga operatorët ekonomikë nëse pas aplikimit të formulës për ofertën anomalisht të ulët, mbi ofertat brenda kufijve ligjorë, do të rezultonte se një apo më shumë oferta janë anomalisht të ulta.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit “propozimi ekonomik” të operatorit ekonomik “Gjeokonsult&Co” shpk, rezulton se vlera e ofertuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi është 2,200,00 lekë pa tvsh. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të sipërcituar, rezulton se vlera minimale e mbikëqyrjes e përllogaritur për objektin “*Studim Projektim Rehabilitim i lagjeve nr.4,5,6 Bashkia Kukës*”, për pesë fazat e projektit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është më e madhe se vlera e ofertuar nga operatori ekonomik “Gjeokonsult&Co” shpk.

KPP gjykon se vlera e ofertuar nga operatori ekonomik Gjeokonsult&Co shpk nuk është në përputhje me VKM nr. Nr.354 datë 11.05.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”, dhe rekomandimin e APP-së, pasi është më e ulët se vlera minimale e përllogaritur nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se duke qenë se kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura.

Në këtë kuptim, Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë të garantojnë që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatori ekonomik ankimues, “Gjeokonsult&Co shpk, ka ofertuar me një vlerë e cila rezulton të jetë nën vlerën minimale të lejuar të përllogaritur nga autoriteti kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Invictus&CEC Group” shpk mbi kualifikimin e shoqërisë “Gjeokonsut&CO” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Gjeokonsult&Co” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga BOE “Invictus”& “CEC Group” shpk për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulence”, me nr. REF-42173-01-25-2018, me objekt “Studim Projektim Rehabilitim i lagjeve nr.4,5,6 Bashkia Kukës”, me fond limit 2,530,000 lekë (pa TVSH), publikuar në datën 26.01.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Gjeokonsult& Co” shpk duke e skualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Invictus” shpk & “CEC Group” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 809 Protokoli, Datë 25.04.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**